

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-221/11**

**Prishtinë**

**30 tetor 2012**

Në çështjen juridike të

**L.Ž.**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

kundër

**Đ.T.**

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

i përfaqësuar nga bashkëshortja

**I.T.**

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filecheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar duke vendosur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/108/2011 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA47326, KPA47327, dhe KPA47328), i datës 13 maj 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 30 tetor 2012, mori këtë:

## AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga L.Ž. me datë 18 nëntor 2011 dhe të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-221/11, GSK-KPA-A-222/11, dhe GSK-KPA-A-223/11, janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-221/11.
- 2- Ankesat e paraqitura nga L.Ž. me datë 18 nëntor 2011 refuzohen si të pabazuara.
- 3- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/108/2011 për sa i takon lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA47326, KPA47327 dhe KPA47328.
- 4- Obligohet pala ankuese L.Ž. që t'i paguaj në Bugjetin e Kosovës shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 30 nëntor 2007, L.Ž., në emër axhës së babait të saj, ka paraqitur 3 (tri) kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së pronësisë në disa ngastra dhe ri-posedimin e tyre. Ajo ka shpjeguar se këto ngastra kadastrale janë regjistruar në emër të P.V.P., axhës së babait të saj, dhe se nuk e din se kush është duke shfrytëzuar ato paluajshmërit dhe nëse janë të uzurpuara.

Për ta mbështetur kërkesën e saj, paraqitësja e kërkesës ka paraqitur në AKP këto dokumente, si në vijim:

- Letërnjoftimin, të lëshuar me datë 12 mars 1995, nga Komuna e e Deçanit;
- Fletën Poseduese no. 193, lëshuar me datë 22 nëntor 2007 nga Shërbimi për Kadastër të Paluajshmërive të Entit Republikan Gjeodezik të Republikës së Serbisë, Komuna e Pejës, zona kadastrale Vitomiricë;
- Aktvdekjen e Ministrisë së Punëve të Mbrendshme dhe Administratës Publike, të Republikës së Malit të Zi, të datës 16 shkurt 2011, që tregon se B.L.P. ka vdekur me 15 janar 1979 në Berane;
- Çertifikatën e Vdekjes së P.V.P., lëshuar me 22 shkurt 2011 në Kragujevc, që tregon se ai ka vdekur me 1 tetor 1975 në Vitomiricë.

Fleta Poseduese Nr. 193, e cila është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës thekson se P.P. ishte pronar i këtyre ngastrave të kërkuara në Komunën e Pejës, Zona Kadastrale Vitomiricë, si në vijim:

Numri i Kolegjit të Apelit dhe numri i AKP-ës	Të dhënat në lidhje me ngastrat kadastrale të kërkuara
GSK-KPA-A-221/11 KPA47326	Ngastra kadastrale no. 690, në vendin e quajtur “Vitomirica”, arë e klasës të 4-të, në sipërfaqe prej 0.66.55 Ha.
GSK-KPA-A-222/11 KPA47327	Ngastra kadastrale no. 692, në vendin e quajtur “Vitomirica”, arë e klasës të 4-të, në sipërfaqe prej 0.07.44 Ha.
GSK-KPA-A-223/11 KPA47328	Ngastra kadastrale no. 697/2, në vendin e quajtur “Vitomirica”, arë e klasës të 3-të, në sipërfaqe prej 1.27.28 Ha.

Sidoqoftë, kjo fletë poseduese, sipas raportit të verifikimit të AKP-ës, i datës 27 korrik 2010 nuk ka mundur të verifikohet. Në vend të kësaj Zyrtarët e AKP-ës kanë gjetur Fletën Poseduese Nr. 193, të datës 21 tetor 2008, duke treguar se parcelat objekt kontesti ishin regjistruar në emër të X.T. [Đ.T.].

Ekipi për njoftim i AKP-ës, ka shkuar në vendet ku pretendohej se ndodheshin ngastrat e kërkuara dhe ka vendosur shenjat që tregonin se pronat ishin objekt kontesti të kërkesave dhe se palët e interesuara duhet t'i paraqisnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Për të gjitha kërkesat në lidhje me ngastrat kadastrale të kërkuara publikimi është bërë me 26 qershor 2009, dhe njoftimi me datë 19 nëntor 2009, përpos kërkesës KPA47327, që i referohet ngastrës 692, njoftimi për të cilën është bërë me 17 nëntor 2009.

I.T. është përgjegjur në kërkesë, duke theksuar se bashkëshorti i saj ishte pronar i këtyre paluajtshmërive dhe se ai e kishte blerë pronën në vitin 1970.

Në mbështetje të pohimeve të saj ajo ka paraqitur këto prova dhe dëshmi:

- Letërnjoftimin e saj, të lëshuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Mbrendshme të Republikës së Kosovës, të datës 14 nëntor 2009;
- Kontratën e Shitblerjes, e datës 20 dhjetor 1997, e lidhur në mes të H.Č., si shitës dhe Đ.T., si blerës, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë VR.Nr.6005/01, e datës 15 tetor 2001;
- Autorizimin e H.Č., të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Sarajevë Vr.nr.4467/1997, i datës 12 nëntor 1997; dhe

- Çertifikatën e të Drejtave Pronësore të Pronës së Paluajshme, të Zyrës Kadastrale Pejë UL-71611015-00193, e datës 20 korrik 2010.

Nga raporti i verifikimit të AKP-ës, i datës 27 janar 2011, shihet se të gjitha këto prova janë verifikuar.

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK), në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KKPK/D/A/108/2011, i datës 13 maj 2011, ka hedhur poshtë kërkesat e L.Ž., për shkak se ajo nuk paraqiti autorizim juridikisht të vlefshëm për ta përfaqësuar axhën e babait të saj në cilësinë e titullarit të së drejtës pronësore, e as që nuk është anëtare e ngushtë e familjes së tij, e cila do të kishte autorizim të paraqiste kërkesë, ashtu siq parashikohet me dispozitat e nenit 5.1 të Udhësesës Administrative (UA) të UNMIK-ut Nr. 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-79.

Vendimi i është dorëzuar ankueses me 20 tetor 2011, ndërsa palës përgjegjëse në akese, ankesa i është dorëzuar me 16 nëntor 2011.

Me 18 nëntor 2011, L.Ž. (tani e tutje: ankuesja) ka ushtruar një ankesë në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve thebësore ligjit procedural dhe material. Ajo ka kërkuar anulimin e vendimit dhe pranimin e ankesës së saj, duke vërtetuar kështu të drejtën e saj të pronësisë në ngastrat kadastrale të kërkuara.

Në ankesat e saja, ajo deklaron se pronësia e kërkuar në kërkesat e saja për parcelat e kërkuara i ka takuar stëraxhës së sajë P.P., pastaj ajo pronësi ka kaluar në emër të gjyshit të sajë L.P., dhe pastaj kjo pronësi ka kaluar në emër të babait të sajë B.P.. Ata e kanë shfrytëzuar për vite pronën. Në vazhdim ajo ajo deklaron se pas vdekjes së babait të saj babait të sajë B.P., me datë 15 janar 1979, duhet që ajo vet tani të disponojë me atë pronë, të cilën askush nuk mund t'ia merr. Derisa ishin gjallë paraardhësit e saj, e kishin shfrytëzuar këtë pronë. Për më tepër paraqitësja e kërkesës deklaron se pretendimet e palës përgjegjëse ishin kontradiktore, dhe se shitësi i pretenduar H.Č. kur nuk kishte qenë pronar i pronës dhe se ky ishte rasti tipik i transaksionit mashtrues dhe kontratës së pavërtetë.

Pala përgjegjëse (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) nuk është përgjigjur.

### **Arsyetim ligjor:**

### **Bashkimi i ankesave:**

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurën e Kolegjit të Apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 3 (tri) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për këto kërkesa është i njëjtë.

Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-221/11, GSK-KPA-A- 222/11 dhe GSK-KPA-A- 223/11, janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-221/11.

### **Për ankesën:**

Gjykata Supreme e Kosovës, vendimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK, dhe pas vlerësimit pretendimeve ankuese gjeti se:

Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur mbrenda afatit ligjor të përcaktuar sipas nenit 12.1 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, që parashikon që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e njoftimit të palëve për vendimin. Kjo për arsye se vendimi i është dorëzuar ankuesit me 20 tetor 2011, ndërkaq që ankesa nga ana e saj është paraqitur me datë 18 nëntor 2011.

Sidoqoftë, ankesa nuk është e bazuar për disa arsye.

Kërkesa bie jashtë jurisdikcionit të KKPK-ës/ Kolegjit të Apelit. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhërin e Komisionit që ka të bëjë me riposedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës provon jo vetëm të drejtën pronësore në pronë por gjithashtu edhe se ai ose jo aktualisht nuk mund të ushtrojë këtë të drejtë për shkak të rrethanave të lidhura direkt ose që janë rezultat i konfliktit të armatosur që ka ndodhë në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Në përputhshmëri me këtë dispozitë ligjore, jurisdikcioni i KKPK-ës është i kufizuar në kërkesat pronësore që janë të lidhura direkt ose që rezultojnë nga ky konflikt. Kolegji i Apelit të AKP-ës duhet që të vlerësoj jurisdikcionin e tij *ex officio*.

Në përputhshmëri me faktet dhe dëshmitë e paraqitura, ankuesi nuk ka vërtetuar se ajo i ka hmbur pronat si rezultat i konfliktit dhe se nuk mund të ushtrojë të drejtat e saja për shkak të këtyre rrethanave. Paraqitësi i kërkesës kishte lindur në vitin 1965 në Berane në Mal të Zi. Dokumentacioni i paraqitur nga ankuesja tregon se babai i saj ka vdekur në vitin 1979 në Malin e Zi. Agja i babait të saj ka vdekur në vitin 1975 në Kragujevc. Nuk ka të dhëna që tregojnë së familja e paraqitësit të kërkesës kishte lëshuar Kosovën për shkak të konfliktit të armatosur dhe/ose se ngastrat ishin uzurpuar vetëm gjatë kohës osë menjëherë pas konfliktit të armatosur në Kosovë. Prandaj, Gjykata nuk mund të gjej kurfarë lidhshmërije, të drejtëpërdrejtë ose edhe indirekte, të këtij rasti me konfliktin e armatosur. Mbi bazën e kësaj, kjo lëndë nuk bie në jurisdikcionin e KKPK-ës/Kolegjit të Apelit të AKP-ës, prandaj KKPK-ja kishte vepruar drejtë kur kërkesa ishte refuzuar.

Gjykata dëshiron të shtojë se ajo pajtohet me vlerësimin e KKPK-ës për sa i takon domosdoshmërisë së autorizimit. Ankuesi, i cili nuk është anëtar i familjes së ngushtë ashtu siq përcaktohet me nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut Nr. 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-79, nuk mund të provoj se ajo vetë është pronare e ngastrave kadastrale të kërkuara. Fleta Poseduese Nr. 193 – e cila nuk është verifikuar nga AKP-ja – konstaton se ngastrat ishin regjistruar ne emrin e P.P.. Gjykata dhe KKPK-ja nuk mund të mbështeten në deklaratën e ankueses. Prandaj, ankueses do t'i duhej autorizimi nga ndonjë anëtar i familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore të ndjerë ose (provë) si trashëgimtare e tij. Meqë ankuesi ankohet se ajo asnjëherë nuk ishte njoftuar për dallimin në mes të emrit të saj dhe emrit të bartësit të së drejtës pronësore, se do të paraqiste problem, gjykata dëshiron të theksoj se: dallimi në emra tregon vetëm se ankuesja nuk ishte anëtare e familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore. Dhe meqë është kështu ajo ose është dashur që t'i ofroj AKP-ës autorizimin e dhënë nga nga anëtari i familjes ngushtë të pronës së regjistruar në emër të bartësit të së drejtës pronësore ose të trashëgimtarëve të tij (gjë të cilën ajo nuk ka mund) ose të dëshmojë se ajo e ka trashëguar pronësinë (gjë që nuk ka mundur ta bëjë për shkak se ajo nuk kishte inicuar procedurën e trashëgimit).

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifatat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.12, 10.1 dhe 10.15 përshtatshëmrisht të UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përlogaritet të jetë si € 20.000: € 30 (€ 50 + 0.5% nga 30.000, por jo më shumë se € 30)

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 30 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë ligjore:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Meqë lënda bie jashtë jurisdiksionit të KKP-ës/Kolegjit të Apelit të AKP-ës, ky vendim nuk e paragjykon të drejtën e ankuesit që të kërkojë vërtetimin e të drejtës së saj pronësore në pronën e kërkuar në gjykatat lokale kompetente.

*Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Urs Nufer, Referent i EULEX-it*